



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 2716/4 prot.

Tiranë, më 08.06.2018

Lënda: Shpallje e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për afishim,  
për efekt njoftimi

**NJËSISË BASHKIAKE NR.8**  
**Blv “Zog I”**  
**Tiranë**

E nderuar zonjë/ zotëri,

Nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është marrë **vendimi nr. 9, datë 23.3.2018 për subjektin e rivlerësimit Erlindi Basha.**

Bazuar në nenin 55, pika 7 e ligjit nr.84/2016, në të cilin parashikohet se: *“Vendimi me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të Komisionit.”*, nga ana e Komisionit janë bërë përpjekjet për komunikimin e vendimit subjektit të rivlerësimit, duke e dërguar vendimin në adresën: **Rruga “Demir Gashi” nr. 3, Tiranë.**

Në kushtet kur në adresën zyrtare të këtij shtetasi nuk është bërë i mundur komunikimi i vendimit, bëhet kjo shpallje publike me efekt 20 (njëzet) ditë, **me qëllim njoftimin e vendimit.**

Një kopje e kësaj shpalljeje vendoset në këndin e njoftimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, një kopje vendoset pranë vendbanimit të fundit të subjektit të rivlerësimit, një kopje pranë njësisë bashkiake që përfshin këtë adresë, si dhe një kopje në faqen zyrtare të internetit të Komisionit.

Bashkëlidhur ju dërgojmë 3 kopje të shpalljes, nga të cilat një kopje afishohet pranë vendbanimit të fundit të subjektit të rivlerësimit **Erlindi Basha** një kopje pranë njësisë bashkiake përkatëse dhe kopja tjetër kthehet pranë Komisionit me mbishkrimin përkatës që shpallja është afishuar si dhe datën e afishimit.

Faleminderit për bashkëpunimin!

**KRYETARI**

**Genta Tafa (Bungo)**

